

V E N D I M
Nr.296, datë 21.6.1993

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.133, DATË
26.3.1993 "PËR ÇELJEN E KURSEVE PËR PËRGATITJEN E PUNONJËSVE TË
PROKURORISË, TË POLICISË HETIMORE DHE TË GJYKATAVE"**

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Rendit Publik dhe Prokurorisë së Përgjithshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.133, datë 26.3.1993, pika 1 ndryshohet si vijon:
"Çeljen e kursit gjashtëmuor për përgatitjen e punonjësve të gjykatave, prokurorive dhe të policisë hetimore".
2. Ministrisë së Drejtësisë, për të përballuar rritjen e shpenzimeve nga zgjatja e afatit të kurseve, i shtohen 4 milionë lekë që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në Buxhetin e Shtetit për vitin 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi